



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
DREJTORIA E KËRKIMIT, PROMOVIMIT AKADEMIK DHE KOMUNIKIMIT
SEKTORI I PROJEKTEVE DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL

Në vitin 2019, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ndërmori një sërë reformash institucionale dhe strukturore, nga nxjerrja e dokumentit të konsoliduar të “Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, deri tek organigrama e re.

Sipas strukture së re të organizimit administrativ të institucionit, projektet u konceptuan në një sektor më vete, nën Drejtorinë e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit, me emërtesën *Sektori i Projekteve dhe Zhvillimit Profesional*.

Linja direkte e bashkëpunimit dhe raportimit në nivelin e lartë akademik është Zv.Rektori për Projektet, Anën Klinike dhe Diagnostike.

Ky sektor u plotësua me staf vetëm vitin e fundit dhe aktualisht është i angazhuar për ndërtimin e databasës së projekteve dhe zhvillimit profesional, duke konsideruar që aktivitetet e sektorit ndiqeshin më përpara nga disa sektorë ndarazi. Dy veprimtaritë kryesore të Sektorit janë:

Projektet- që kanë për qëllim përmbushjen e strategjive, objektivave, qëllimeve dhe detyrave funksionale akademike dhe administrative të institucionit për rritje dhe zhvillim të mëtejshëm të kapaciteteve në infrastrukturë dhe capital human.

Zhvillimi Profesional- veprimtari që organizohet përmes Qendrës së Zhvillimit Profesional të UMT-së sipas rregullores së posaçme dhe procedurave për akreditim eventesh.

I gjithë informacioni lidhur me vepritarinë e Sektorit të Projekteve dhe Zhvillimit Profesional, pasqyrohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së, në faqen zyrtare të rrjeteve sociale të UMT-së dhe përmes njoftimeve dhe komunikimeve në adresat elektronike me domain të institucionit.

- Kordinator Akademik dhe Institucional për Projektet Evropiane është:

Prof. Dr. Alma Idrizi

Email: alma.idrizi@umed.edu.al

- Regjistrimi i UMT-së në Erasmus+ dhe European Solidarity Corps me kodet në link si vijon:

<https://webgate.ec.europa.eu/erasmus-esc/organisation-registration/screen/home>

Dy dokumentat më të rëndësishme lidhur me edukimin në Bashkimin Evropian janë: Korniza e Edukimit dhe Trajnimit 2020 (ET2020) dhe Axxhenda (e Rishikuar) e Arsimit të Lartë në Evropë.

Nga BE, kërkohen investime të qëndrueshme dhe thelbësore në mënyrë që arsimit të shndërrohet në faktor zhvillimi. Aktivitetet e BE-së janë konceptuar të tilla që të shtojnë elementin ndërkombëtar në edukim, mësimdhënie, hulumtim dhe politikë-bërje në arsimin e lartë.

Programet kryesore lidhur me edukimin në BE janë: Erasmus + dhe Horizon 2020. Përmes tyre, BE mbështet shkëmbime ndërkombëtare për student, staf akademik dhe studiues, si dhe bashkëpunim të strukturuar midis institucioneve të arsimit të lartë dhe autoriteteve publike në vende të ndryshme.

Objektivi është krijimi i mundësive të reja për njerëzit në arsimin e lartë për të mësuar nga njëri-tjetri përtej kufijve kombëtar dhe për të punuar së bashku në projekte të përbashkëta për të zhvilluar një mësim dhënie-nxënie-marrje të mirë, për të kryer hulumtime të shkëlqyera dhe për të promovuar inovacionin.

UMT është e dedikuar të orientojë përpjekjet e saj në projekte në linjë me politikat e sipër përmendura të BE, por dhe me strategjitë ndërkombëtare që shkojnë përtej BE, të tilla si Agenda 2030 (Sustainable Development Plan 2030) e Kombeve të Bashkuara (UN) apo dhe organizatave të tjera të të njëjtit nivel (WHO, ILO etj).

MARRËVESHJET NDËRINSTITUCIONALE:

UMT-të ka gjithsej 78 Marrëveshje Ndërinstitucionale, nga të cilat 45 janë ndërkombëtare dhe 33 kombëtare.

Kombëtare

Nr.	Institucioni
1	Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”
2	Universiteti “Aldent”
3	Universiteti “Albanian University”
4	Universiteti i Tiranës
5	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
6	Shkolla e Lartë Private “Logos”
7	Akademia e Studimeve “Reald”
8	Universiteti i Sporteve i Tiranës
9	Universiteti Politeknik i Tiranës
10	Koral -INC
11	Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë
12	Universiteti Fan S. Noli
13	Universiteti Aleksander Xhuvani Elbasan
14	Universiteti Luigj Gurakuqi, Shkoder
15	Universiteti Bujqësor i Tiranës
16	Kolegji i larte profesional TESS
17	Universiteti Eqrem Cabej, Gjirokaster

18	Kuvendi i Shqipërisë
19	Qendra nderinstitucionale e rrjetit akademik shqiptar (RASH)
20	Fidia Pharma Group
21	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
22	Universiteti Hamburgut Gjermani
23	Universiteti Aldent
24	Albanian-American Development Foundation
25	Fondacionin spitalor të Nënës dhe Fëmijës
26	Qendra Media dhe çështjet Shoqërore
27	Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe pajisjeve mjekësore
28	Universiteti Marin Barleti
29	Lekli Pharma
30	Akademinë e Shkencave të Shqipërisë
31	Akademinë e Forcave të Armatosura
32	Albanian Committee of Medical Students (ACMS)
33	Unniversiteti Evropian i Tiranës

Ndërkombëtare

Nr	Institucioni
1	Universiteti Firatit, Turqi
2	Universiteti i Palermos, Itali
3	Universiteti Camerino, Itali
4	Universiteti “Gabriele D’Annunzio”, Itali
5	Universiteti “Aldo Moro”, Itali
6	Universiteti i Padovës, Itali
7	Universiteti i Sienes, Itali
8	Universiteti i Strugës, Maqedoni
9	Universiteti “Foro Italico”, Itali
10	Etablissement Francais Du Sang, Francë
11	Universiteti “Hasan Prishtina, Kosovë
12	Universiteti “Biznes dhe Teknologji”, Kosovë
13	Universiteti “Altinbas”, Turqi

14	Universiteti Istinye, Turqi
15	International Youth Felloëship
16	Universiteti “Kadri Zeka”, Gjilan, Kosovë
17	Kolegji “Rezonanca”, Prishtinë, Kosovë
18	Universiteti i Aquilas, Itali
19	Universiteti Charles, Çeki
20	Universiteti “Sophia Antipolis”, Francë
21	Universiteti i Tetovës, Maqedoni
22	Universiteti Krakoë (Jagiellonian), Poloni
23	Universiteti Porto, Portugali
24	Universiteti Pitesti, Rumani
25	Universiteti Tor Vergata, Romë, Itali
26	Trakya University, Turqi
27	Universiteti Teramo, Itali
28	Bezmialem Vakif University, Stamboll, Turqi
29	Ljubljana University, Slloveni
30	Tallinn health care college, Estoni
31	Kolegji AAB, Prishtine Kosove
32	Universiteti Alma Lauera, Bolonjë, Itali
33	Universiteti i NIS, Serbi
34	Universiteti Poznan, Poloni
35	Universiteti Baskent, Ankara, Turqi
36	Kolegji Heimerer, Kosovë
37	Universiteti i Salernos, Itali
38	Universiteti Sancti Cyrilli A.D. 1669, Malta
39	United Nations Childrens Fund (UNICEF)
40	HAP Health for All, Zvicër
41	German Corporation for international cooperation GIZ
42	Universiteti i Janinës, Greqi
43	International European University Ukrainë
44	The Berlin School of Health Sciences, Gjermani
45	University of Health Sciences, Lithuania

PROJEKTE NË ZBATIM:

UMT-të ndjek dhe zbaton gjithësej 8 projekte, prej të cilave 2 kombëtare dhe 6 ndërkombëtare.

Kombëtare

Nr.	Titulli
1	AKKSHI- "Aplikimi i imunocitometrisë me fluks në studimin e funksionit fagocitar dhe limfocitarsi dhe në imunofenotipizimin qelizor të nyjeve limfatike"
2	AKKSHI- "Identifikimi i teknikës optimal intraoperatore të kardiomioplastikës qelizore në mënyrë simultane me rivaskularizimin kirurgjikal tek zemrat humane të infarktuara nëpërmjet implantimit të qelizave staminale autologe në rrugë të ndryshme. Një studim eksperimental"

Ndërkombëtare

Nr.	Titulli
1	EUSCREEN (Implementation of cost-optimized childhood vision and hearing screening programmes in middle-income countries in Europe) – Horizon2020; No: 733352
2	GRADUA (Capacity Building) - GRaduates Advancement and Development of University capacities in Albania. No: 585961-EPP-1-2017-1-AL-EPPKA2-CBHE-SP
3	QUADIC (Capacity Building) - Quality development of international cooperation and project management. No: 609786-EPP-1-2019-1-XK-EPPKA2-CBHE-JP
4	Central European Initiative (CEI), in cooperation ëith Regio Emilia, Italy and Ministry of Health and Social Protection, Albania
5	IDEA -Inclusive tertiary EDucation in the West BalkanS. Project Reference Number: 618859-EPP-1-2020-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP
6	Projekti Digicare4you ne kuader te Horizon2020-TBD

PROGRAMET E SHKËMBIMIT

Programet e shkëmbimit të **Erasmus+** ndahen në programe për student dhe staf (akademik dhe/ose administrativ) ku institucion pritës është UMT-të dhe në programe për student dhe staf (akademik dhe/ose administrativ) ku institucion pritës është një institucion i arsimit të lartë jashtë vendi. Aktualisht UMT kryen mobilitete me 16 Universitete Evropiane, listuar sa më poshtë:

Nr.	Institucioni
1	Universiteti i Aquilas, Itali
2	Universiteti "Ondokuz Mayıs", Samsun, Turqi
3	Universiteti i Craioves, Rumani
4	Universiteti i Saarlandit, Gjermani
5	Universiteti i Camerinos, Itali

6	Universiteti i Bolonjes, Itali
7	Universiteti i " Tor Vergata" Rome
8	Universiteti i Wroclaë, Poloni
9	Universiteti i Saarlandit, Gjermani
10	Universiteti i Graz, Austri
11	Universiteti Aristotle, Selanik, Greqi
12	Universiteti i Ferrarës, Itali
13	Universiteti i Catantias, Itali
14	Kolegji i Shkencave të Aplikuara "LAVOSLAV RUZICK" Vukovar, Kroaci
15	Universiteti Granada, Spanje
16	Universiteti Côte d'Azur, Nice, France

Të tjera programe për mobilitet të stafit dhe të studentëve përfshijnë eksperiencat në kompani apo organizata. I tillë është rasti i Kompanisë Farmaceutike Fidia, me qëndër në Padova, Itali.

Formatet Tip të dokumentacionit të nevojshëm të Erasmus + janë:

1. Learning Agreement for Studies

- [.docx](#)
- [.odt](#)
- [pdf](#)
- [Guidelines on how to use the Online Learning Agreement for Studies](#)

2. Learning Agreement for Traineeships

- [.docx](#)
- [.odt](#)
- [pdf](#)
- [Guidelines on how to use the Learning Agreement for Traineeships](#)

3. Mobility Agreement

A. Staff Mobility for Teaching

https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/sites/default/files/files/resources/mobility-agreement-teaching_en.pdf

B. Staff Mobility for Training

https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/sites/default/files/files/resources/mobility-agreement-training_en.pdf

Vlerësimi i dosjeve të aplikanteve bëhet nga Komisioni i ERASMUS, i cili ka në përbërje 2 pjesëtarë të Rektoratit dhe nga 1 përfaqësues nga çdo Fakultet në rang Zv/Dekani. Vlerësimi i dosjeve bëhet në bazë të rregullave të përcaktuara nga BE.

Dokumentacioni bazë i studentit të interesuar për t'u bërë pjesë e një programi shkëmbimi/mobiliteti duhet të përmbajë:

1. CV;
2. Fotokopje të Pasaportës;
3. Certifikatë për mbrojtjen e Gjuhës së Huaj;
4. Vërtetim Studenti;
5. Listë Notash;
6. Letër Motivimi;
7. Learning Agreement (pas fazës së kualifikimit);
8. Çdo document tjetër specifikuar në thirrje.

Dokumentacioni bazë për stafin akademik apo administrativ të interesuar për t'u bërë pjesë e një programi shkëmbimi/mobiliteti duhet të përmbajë:

1. CV dhe Listë të Publikimeve;
2. Fotokopje të Pasaportës;
3. Certifikatë për mbrojtjen e Gjuhës së Huaj;
4. Vërtetim Punësimi;
5. Vetë-deklarim nëse keni kryer me parë një program këmbimi/mobiliteti në kuadër të Erasmus+ ose jo;
6. Letër Motivimi;
7. Mobility Plan (pas fazës së kualifikimit);
8. Çdo dokument tjetër specifikuar në thirrje.

THIRRJET (CALLS) azhurnohen në çdo kohë në të gjithë kanalet e komunikimit që përdor universiteti dhe ndahen si në strukturën sa më poshtë:

A. Për PROJEKTE

- 1. Kombëtare**
- 2. Ndërkombëtare**

B. Për MOBILITET

3. Student

4. Staf:

- a) Akademik**
- b) Administrativ**

C. Për BURSA STUDIMI

Përsa më sipër, në zbatim të Programit të Transparencës, të dhënat do të përditesohen çdo 3 muaj nga Sektori i Projekteve dhe Zhvillimit Profesional.